



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr.167/1 Prot.

Tiranë, më 19.01.2026

**V E N D I M**

**Nr. 14, datë 19. 01.2026**

Bazuar në ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr. 256, datë 04.11.2025, e paraqitur nga z. I. Gj., kundër Bashkisë Tiranë (Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social, Drejtoria e Strehimit Social), me pretendimin për diskriminim, për shkak të “aftësisë së kufizuar<sup>1</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Subjekti ankues, në parashtrimet e depozituara pranë KMD-së, ndër të tjera, citon se: *“Po i drejtohem Komisionerit për një diskriminim që po i bëhet familjes time. Unë, I. Gj., jam me aftësi të kufizuara, ku dhe bashkëshortja ime, M. Gj., dhe djali, M. Gj., janë me aftësi të kufizuara si unë. Ne jemi diskriminuar nga Drejtoria e Strehimit Social, Bashkia Tiranë.*

*Une po ju sqaroj problemin tim: Jetoj 13 vite me qira dhe nga këto 13 vite vetëm 5 vite jam trajtuar me bonus qiraje. Kam aplikuar edhe vite të tjera me të njëjtat dokumenta për një shtëpi sociale, ku më është mohuar e drejta. Vetëm këtë vit kam bërë 3 herë aplikime për bonus qiraje dhe nuk më janë aprovuar. Heren e pare kemi aplikuar më 05.12.2024 për banesë me kosto të ulët. Më dhanë përgjigje gojarisht se jam refuzuar, pasi kisha aplikuar pesë ditë para fillimit të datës së duhur të aplikimeve.*

*Heren e dyte kemi aplikuar në mars të 2025 për bonus qiraje, por këtë radhë refuzimi u bë pasi nuk u mblodh Këshilli Bashkiak.*

---

<sup>1</sup> Referuar Librezës nr. 1078, dt. 26.03.2025 të Shërbimit Social Shtetëror, z. I. Gj., është invalid i Grupit të I.

*Heren e tretë kemi aplikuar më 02.09.2025, dhe këtë radhë u penalizuam pasi shtëpia ku ne jetojmë me qera është në proces legalizimi dhe Drejtoria e Strehimit Social, Bashkia Tiranë, na kërkon një vërtetim aktual për këtë gjë. ASHK-ja nuk e jep këtë vërtetim aktualisht.*

*U jam lutur edhe për shtëpi sociale dhe më kanë refuzuar. Për problemin tim kam bërë takime me Drejtorinë e Strehimit Social, Bashkia Tiranë dhe, pasi i kam plotësuar të gjitha kërkesat e tyre të cilat kanë kosto, përsëri asgjë nuk më është realizuar. Përfundimisht, unë nuk kam përfituar bonusin e qerasë. Kanë kaq vjet që më sjellin verdalle e më zvarrisin. Rrezikohem të dal jashtë nga shtëpia ku jetoj, pasi kam shtatë muaj që nuk kam paguar qiranë, duke u justifikuar te i zoti shtëpisë se nuk kam për të marrë bonusin nga njësia bashkiake. Ndodhem në situatë të vështirë, me shpresën se do të marr një zgjidhje nga ana Juaj.*

Në përfundim ankuesi, kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit dhe zgjidhjen e situatës duke siguruar përfitimin e një banese sociale.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Bazuar në nenin 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

## **Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 1539/2 prot., datë 11.11.2025, Komisioneri, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Bashkia Tiranë, për ankesën e bërë nga pala ankuese, duke kërkuar në mënyrë të veçantë informacion në lidhje me çështjen.
2. Duke marrë shkas nga mosdërgimi i informacionit të kërkuar me shkresën e mësipërme me shkresën nr.1539/3 prot., datë 04.12.2025 të Komisionerit iu rikërkua informacioni.

3. Në përgjigje të kërkesave të mësipërme për informacion, me shkresën nr. 39060/1 prot., datë 05. 12.2025<sup>2</sup> Bashkia Tiranë ktheu përgjigje duke informuar Komisionerin se:

*Në përgjigje të shkresës suaj me nr. prot. 1539/2, datë 11.11.2025, protokolluar në Bashkinë Tiranë me nr. prot. 3906, datë 12.12.2025, Drejtoria e Programeve Sociale dhe Monitorimit të Strehimit, ju bën me dije se: Të pastrehët trajtohen me një nga programet e strehimit të parashikuara në ligjin 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar dhe aktet ligjore e nënligjore në zbatim të tij.*

*Në zbatim të vendimeve të Këshillit Bashkiak nr. 126, datë 26.11.2019, nr. 169, datë 18.12.2020 dhe nr. 29, datë 06.04.2022, z. I. Gj., ka qenë përfitues i programit social të strehimit “Subvencionimi i Qirasë”. Nëpërmjet shkresës nr. 873 prot., datë 11.03.2025 Njësia Administrative Nr. 4, ka përcjellë formularin e aplikimit për fazën e parë për të përfituar nga programi social i strehimit “Subvencionimi Qirasë”, ku z. Gj., është shpallur fitues dhe ka vijuar me plotësimin e fazës së dytë.*

*Pas plotësimit të praktikës është komisioni i strehimit që vlerëson dokumentacionin përkatës që dorëzohet nga individ/familjet që aplikojnë për programet sociale të strehimit. Konkretisht strehimi pas shqyrtimit të dosjes së z. Gj., vendosi t’i linte 1 (një) muaj afat pasi kontrata e qirasë e lidhur pranë Njesisë Administrative nr. 4 me nr. prot. 31 datë 27.02.2025 rezulton të ketë bashkëlidhur një vërtetim për legalizim pa leje me të dhëna që nuk janë referuar tek kontrata e qirasë.*

*Pas dorëzimit të dokumentacionit nga z. Gj., komisioni i strehimit rishqyrtoi dosjen dhe vendosi ta skualifikojë pasi kontrata e qirasë nr. prot. 31, datë 27.02.2025, e lidhur pranë Njesisë Administrative është plotësuar pas lënies së afatit 1-mujor, me shkrim të dhënat vetëm në lidhje me aplikimin për legalizim, por jo të pronës konkrete që kërkohet të legalizohet. Gjithashtu, rezultonte të kishte bashkëlidhur një vërtetim për legalizim të ndërtimit pa leje me të dhëna që nuk specifikonin konkretisht objektin e banimit për të cilin kërkohet legalizimi. Vërtetimet që jepen nga ASHK, duhet të jenë të përditësuara, në rastin konkret vërtetimi daton i vitit 2019, duhet të rifreskohet statusi i aplikuesit për përfitim, pasi ka ndryshuar ligji i strehimit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.*

*Aplikimi për përfitimin nga programi social i strehimit “Banesë sociale me qira”, faza e parë, kryhet përmes portalit qeveritar e-Albania, në periudhën 10.12.2024 – 22.12.2024. Sa i përket aplikimit zyrtar të z. Gj., për programin social të strehimit “Banesë me kosto të ulët”, do të trajtohet sipas procedurave dhe kriterëve ligjore në fuqi. Ndërkohë, për programin social të strehimit “Banesë sociale me qira”, do të ketë një njoftim publik në momentin e vënies së tij në zbatim, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.*

---

<sup>2</sup> Administruar pranë Komisionerit me nr. 1539/4 prot., datë 09.12.2025.

*Në lidhje me vërtetimin që keni bashkëngjitur, bëjmë me dije se nga viti 2022 deri në vendimin e fundit të Këshillit Bashkiak janë trajtuar me programin social “Subvencionimi i Qirasë” 267 individ/familje me A.K. Aktualisht, z. I. Gj., ka aplikuar sërish dhe është shpallur fitues i fazës së parë për të përfituar nga programi “Subvencionimi i Qirasë”, dhe po vijon me plotësimin e dokumentacionit përkatës të fazës së dytë sipas ligjit 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar dhe aktet ligjore e nënligjore në zbatim të tij, me qëllim shqyrtimin nga komisioni i strehimit.*

*Z. I. Gj., është pritur fizikisht pranë zyrave të Drejtorisë së Programeve Sociale dhe Monitorimit të Strehimit duke u koordinuar dhe me Njësinë Administrative Nr. 4 me qëllim dhënien e gjithë asistencës dhe orientimeve të nevojshme për plotësimin e dokumentacionit përkatës.*

*Bashkia Tiranë ka një kuadër shërbimesh specifike për personat me aftësi të kufizuara, që përfshijnë strehim, mbështetje sociale, rehabilitim, integrim dhe përgatitje për jetë të pavarur. Personat me aftësi të kufizuara janë kategori prioritare kur vlerësohen për përfitime strehimi. Bashkëlidhur po ju përcjellim dokumentacionin përkatës që ne disponojmë.*

4. Me shkresën nr.1539/5 prot., datë 11.12.2025, të Komisionerit, i është përcjellë ankuesit shkresa nr. 39060/1 prot., datë 05. 12.2025 e Bashkisë Tiranë, duke i dhënë të drejtën për të paraqitur kundërshtimet e tij lidhur me qëndrimin e mbajtur nga institucioni. Ankuesi nuk dërgoi asnjë përgjigje.
5. Me shkresën nr. 339 prot., datë 07. 01.2026<sup>3</sup> Bashkia Tiranë, ka informuar Komisionerin se: *Në zbatim të vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 105, datë 18.12.2025, për sistemin në banesa sociale me qira në Shkozë të disa familjeve në nevojë, z. Gj., do të sistemohet në banesë sociale në Shkozë, ish-Fonderia Mekanike, për një afat 1 (një) vjeçar.*
6. Me shkresën nr. 60/1 prot., datë 09.01.2026, është administruar pranë Komisionerit, kërkesa e z. I. Gj., me anë të cilës është shprehur se: *Unë, I. Gj., në cilësinë e subjektit ankues, ju drejtohem përmes kësaj kërkesë për t’ju vënë në dijeni se tërhiqem nga ankesa nr. 256, datë 04.11.2025, e paraqitur prej meje pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kundër Bashkisë Tiranë, për shkak të aftësisë së kufizuar.*

*Arsyeja e tërheqjes sime është se Bashkia Tiranë më ka njoftuar se ka plotësuar kërkesën time duke më sistemuar mua dhe familjen time me banesë sociale me qira, në zonën e Shkozës, ish-fonderia, për një afat 1-vjeçar.*

*Në këto kushte, duke qenë se objekti i ankesës është zgjidhur dhe unë jam sistemuar, nuk kam më interes ligjor për vijimin e procedurës administrative të kësaj ankese pranë institucionit tuaj. Gjithashtu dëshiroj të shpreh falënderimet e mia për Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për trajtimin e ankesës sime, vëmendjen e treguar ndaj problematikës së parashtruar dhe angazhimit institucional në mbrojtje të barazisë dhe mosdiskriminimit.*

---

<sup>3</sup> Administruar pranë Komisionerit me nr. 1539/4 prot., datë 09.12.2025.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se kërkesa e palës ankues, ose ajo që pala ankues kërkon të arrijë ose të sigurojë nëpërmjet paraqitjes së ankesës, objekt shqyrtimi dhe fillimit të kësaj procedure administrative, është përmbushur nëpërmjet plotësimit të kërkesës së saj nga Bashkia Tiranë, e cila ka siguruar sistemimin e saj dhe të familjes me banesë sociale me qira në zonën e Shkozës, ish-Fonderia, për një afat 1-vjeçar, duke eliminuar kështu çdo interes ligjor të mëtejshëm për vijimin e procedurës.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.”

Neni 90, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative (K.P.A), ka parashikuar se: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Në nenin 94<sup>4</sup>/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin procedimi administrativ ka filluar mbi bazën e ankesës së palës ankuese është përmbushur në thelb, pasi u zgjidh problematika e adresuar pranë Komisionerit.

Për rrjedhojë është përmbushur edhe qëllimi i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për sigurimin e të drejtës së çdo personi për:

- “a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;
- b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;
- c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin”.

Përfundimisht, referuar sa më sipër, si dhe duke mbajtur në konsideratë:

- Masat efektive konkrete të ndërmarra nga ana e Bashkisë Tiranë, përmes plotësimit të kërkesës së palës ankues, duke siguruar sistemimin e saj dhe të familjes me banesë sociale me qira në zonën e Shkozës, ish-Fonderia, për një afat 1-vjeçar;

---

<sup>4</sup> “Tërheqja e ankesës”.

- Përbushjen e qëllimit për të cilin ishte iniciuar ankesa konkrete, duke eliminuar çdo interes ligjor për vijimin e procedurës; si dhe
- Qëllimin parandalues të LMD-së, ndërgjegjësimin dhe ndërmjetësimin për zgjidhje miqësore dhe zbatim efektiv të tij, e jo vetëm karakterin konstatues dhe ndëshkues të vendimmarrjeve të KMD-së;

Komisioneri arrin në përfundimin se, procedura administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 256, datë 04.11.2025, të paraqitur nga z. I.Gj., kundër Bashkisë Tiranë, duhet të deklarohet e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, për shkak se qëllimi për të cilin ka filluar procedimi administrativ është përbushur në thelb, problematika e adresuar pranë Komisionerit është zgjidhur, si dhe për shkak të tërheqjes së subjektit ankues nga ankesa.<sup>5</sup>.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe nenet 32 e 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 256, datë 04.11.2025, e paraqitur nga z. I. Gj., kundër Bashkisë Tiranë, pa një vendim përfundimtar, pasi është arritur qëllimi dhe efektiviteti për të cilin ka filluar procedura administrative.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

---

<sup>5</sup> Për analogji citojmë vendimet e KMD-së: Nr. 107/2024, Nr. 181/2024.